

**Memorandum Qëllimi
ndërmjet
Qeverisë së Republikës së Shqipërisë
dhe
Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës**

Në njohje të dëshirës së Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të bashkëpunuar në luftën kundër terrorizmit;

Për të forcuar më tej miqësinë dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre;

Në përputhje me interesin e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të mbështetur programe praktike për konsolidimin e aftësive të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në luftën kundër terrorizmit;

Bazuar në rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara, në veçanti UNSCRs 1373 (2001) dhe 2178 (2014), si dhe në përputhje me marrëveshjen “Për shkëmbimin e informacionit për verifikimin e terrorizmit”, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës”, nënshkruar më 26 prill 2016.

Në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar të dy shteteve, duke respektuar privacinë dhe të drejtat e liritë themelore.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës deklarojnë qëllimin e tyre për të kryer sa më poshtë:

Neni (1)

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës synon të kontribuojë, në varësi të disponueshmërisë së fondeve, duke mbështetur kapacitet e autoriteteve të sigurisë që punojnë në pikat e hyrjes në Shqipëri, si më poshtë:

- a) Sigurimin e Shqipërisë me Sistemin për Krahasimin dhe Vlerësimin e Sigurt të Identifikimit Personal (PISCES) për monitorimin e lëvizjes së udhëtarëve te pikat e hyrjes që do të përcaktohen bashkërisht nga të dy qeveritë;
- b) Instalimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike të këtij sistemi në pikat e hyrjes që do të përcaktohen bashkërisht nga të dy qeveritë;
- c) Trajnimin e personelit shqiptar për operimin dhe mirëmbajtjen e këtij sistemi.

Neni (2)

Me bashkëpunimin e Qeverisë së Shqipërisë, Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës synon të instalojë dhe të mirëmbajë të gjitha pajisjet elektronike të nevojshme për sistemin PISCES, duke filluar në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, si dhe do të zgjerohet më pas në aeroporte dhe pikat kufitare të tjera të caktuara nga autoritetet e Qeverisë së Shqipërisë në bashkërendim me autoritetet e Shteteve të Bashkuara.

Neni (3)

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës synon të kontribuojë në përgatitjen e infrastrukturës së ofruar nga Qeveria e Shqipërisë, të nevojshme për instalimin dhe operimin e PISCES në mënyrë të vazhdueshme. Sistemi do të plotësojë të gjitha funksionalitetet që i nevojiten Ministrisë së Brendshme.

Neni (4)

Ministria e Brendshme e Qeverisë së Shqipërisë synon të fillojë përzgjedhjen e personelit të qeverisë pritëse për të operuar dhe mirëmbajtur sistemin PISCES, me kusht që Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të ketë si qëllim trajnimin e këtij personeli për të krijuar një kuadër të kualifikuar për këtë sistem.

Neni (5)

Ministria e Brendshme e Qeverisë së Shqipërisë synon të përjashtojë nga taksa e TVSH-së dhe detyrimet doganore të gjitha mjetet dhe pajisjet kompjuterike që i përkasin sistemit PISCES dhe që importohen në dobi të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Neni (6)

Ministria e Brendshme e Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës synojnë të bashkërendojnë rishikime periodike në mënyrë që të inventarizohen dhe të përditësohen mjetet dhe pajisjet kompjuterike të siguruara nga Shtetet e Bashkuara për sistemin PISCES.

Neni (7)

Ministria e Brendshme e Qeverisë së Shqipërisë ka për qëllim të vendosë në punë, administrojë dhe të mirëmbajë pajisjet e parashikuara për sistemin PISCES posaçërisht për qëllimet e specifikuara këtu dhe në përputhje me të gjitha ligjet shqiptare që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale të garantuara për qytetarët e Republikës së Shqipërisë dhe shtetasit e huaj që vizitojnë Shqipërinë, dhe me të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen me zbulimin dhe ndalimin e personave të kërkuar ndërkombëtarisht. Të dyja qeveritë synojnë të bashkërendohen përpara çdo transferimi apo zhvendosjeje të mjeteve dhe pajisjeve kompjuterike të PISCES.

Neni (8)

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Qeveria e Shqipërisë synojnë të konsultohen në mënyrë periodike mbi zbatimin e këtij Memorandumi Qëllimi.

Neni (9)

Me qëllim zbatimin e këtij Memorandumi Qëllimi, përfshi transmetimin dhe marrjen e çdo njoftimi, kërkesë, dokumenti ose ndonjë komunikimi tjetër, pikat e kontaktit duhet të jenë:

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, Ministri i Brendshëm ose çdo person i caktuar nga Ministri; dhe

Për Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, ose çdo person i caktuar nga Ambasadori.

Neni (10)

Ky Memorandum synohet të hyjë në fuqi në datën që nënshkruhet.

Ky Memorandum ka për qëllim të vazhdojë të jetë në fuqi për një periudhë të pacaktuar kohe.

Neni (11)

Secila Qeveri duhet të përpiqet të sigurojë njoftim me shkrim mbi qëllimin e saj për ta përfunduar këtë Memorandum Qëllimi.

Nënshkruar në SHBA, më 22 Mars 2018 në dy (2) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike.

Për Qeverinë e
Republikës së Shqipërisë



Për Qeverinë e
Shteteve të Bashkuara të Amerikës

